

POPULLSIA E KAZAVE DIBËR E EPËRME DHE DIBËR E POSHTME NË REGJISTRAT OSMANË (1845 - 1858)

Regjistrimet e popullsisë në Perandorinë Osmane

Perandoria Osmane për të ruajtur ekuilibrat e strukturave shtetërore të saj dhe për të parandaluar shkëputjen e popujve në bazë të përbërjes etnike të mbështetur nga Fuqitë e Mëdha, shpalli reformat e Tanzimatit, me anë të një dekreti në vitin 1839, sipas të cilit qytetarëve të Perandorisë u sigurohej jeta, nderi dhe u premtohej se do të ndiqej një sistem i drejtë, i rregullt në vjeljen e taksave.¹ Për të zbatuar reformat që diktoi ky dekret në aspektet administrative, politike, sociale, ekonomike dhe ushtarake, u ndje i nevojshëm rivlerësimi i burimeve të saj njerëzore. Synimi i këtyre regjistrimeve nuk ishte raportimi i numrit të përgjithshëm të popullsisë, apo vlerësimi i strukturës së saj shoqërore-etnike, por për të ditur numrin e personave meshkuj që përmbushnin kushtet për shërbim ushtarak nga myslimanët, apo të taksapaguesve nga jomyslimanët.

Sa i përket zonës së marrë në studim, mund të thuhet që nuk ka ndodhur regjistrimi i vitit 1831.² Regjistrime të popullsisë së kësaj zone në funksion të realizimit të reformave të Tanzimatit, i përkasin periudhës kohore midis viteve 1845-1858, ku Dibra kishte statusin e kazasë dhe administrativisht bënte pjesë në Sanxhakun e Ohrit të Vilajetit të Rumelisë. Në këto deftere Dibra ishte e ndarë në Kazanë e Dibrës së Sipërme dhe në Kazanë e Dibrës së Poshtme.³

1 Barabara Jelavich, **Balkan Tarihi 18. Ve 19. Yüzyıllar**, Küre Yayınları, Cilt 1, İstanbul 2009, f. 309

2 Në kërkimet që kemi kryer në Arkivin Osman, rreth regjistrimeve të popullsisë, nuk kemi hasur të dhëna për numrin e popullsisë së Dibrës nga censusi i vitit 1831. Edhe në studimin e Kemal Karpatit nuk ka të dhëna për popullsinë e Dibrës në rezultatet e nxjerra prej tij nga regjistri i vitit 1831. Karpat, **po aty**, f. 130; Numrin e popullsisë së Dibrës (8400 banorë) e përmend në veprën e tij studiuesi shqiptar Zija Shkodra. Zija Shkodra, **Qyteti shqiptar gjatë Rilindjes Kombëtare**, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë, 1984, f. 200

3 Alketa Gjoni, *Ndarja dhe organizimi administrativ i Sanxhakut të Dibrës, gjatë viteve (1839-*

Regjistrimi i vitit 1845 jep të dhëna për numrin e meshkujve të popullsisë jomyslimane, emërtuar nën etiketimin reaja (raja), pa bërë dallime etnike⁴, fetare apo gjuhësore. Regjistrimet e viteve 1848/1853 numërojnë edhe popullsinë myslimane të këtyre kazave. Ndërsa në regjistrin e vitit 1858, kemi studim të lëvizjes së popullsisë nga kazatë e Dibrës për në qytetet osmane. Por në regjistrimet në vazhdim të kryera nga Zyra e Gjendjes Civile, në vitet 1848/53, përveç numrit të popullsisë jomyslimane dhe egjiptiane, jepen të dhëna edhe për numrin e popullsisë myslimane.⁵ Gjatë regjistrimit të vitit 1858, është kryer përsëri regjistrimi vetëm i popullsisë jomyslimane dhe egjiptiane. Këto regjistrime janë kryer nga punonjës të gjendjes civile, të ndihmuar nga punonjësit vendas, kryepleqtë e fshatrave, imamët dhe priftërinjtë e zonës. Regjistrime të popullsisë janë realizuar edhe pas vitit 1867, ku Dibra ka fituar statusin sanxhak, por që këto regjistrime nuk janë pjesë e analizës së këtij studimi.

Popullsia e kazasë së Dibrës së Epërme në regjistrin e vitit 1845

Në censusin e vitit 1845 për Kazanë e Dibrës së Epërme dhe Kazanë e Dibrës së Poshtme gjenden shtatë regjistra që tregojnë numrin e popullsisë dhe një regjistër që tregon sasinë e dhënë të taksës së xhizjes, por që është me rëndësi për të dhënat demografike që përmban. Në këto regjistra jepen të dhëna për numrin e shtëpive të fshatrave dhe numrin e meshkujve (sipas moshës dhe veçorive fizike) të popullsisë jomyslimane dhe numrin e ciganëve myslimanë dhe jomyslimanë në Kazanë e Dibrës së Epërme dhe në Kazanë e Dibrës së Poshtme. Në këtë vit, siç e cekëm edhe më sipër, nuk ka regjistër me të dhëna për numrin e popullsisë myslimane. Për këtë arsye, numrin më të madh e zë popullsia jomyslimane dhe pjesën e mbetur e zënë egjiptianët myslimanë.

Në regjistrin e vitit 1845 numri i zonave të banuara të Kazasë së Dibrës së Epërme është 98, nga këto 3 çifligje, 12 lagje dhe 83 fshatra. Nga këto, 10 lagje i përkasin qendrës së kazasë⁶; 9 fshatra krahinës Ova (Fusha)⁷; 1

1912), *Revista Shenja*, Shkurt 2020, f. 84

4 Ndërsa popullsia egjiptiane (Koptët) prezente në këto kaza gjatë numërimit është ndarë në dy grupime, egjiptianë jomyslimanë dhe egjiptianë myslimanë.

5 BOA, NFS, 05384, BOA, NFS, 05389, BOA, ML.CRD.d, 00934.

6 BOA, NFS. d, 05384.

7 BOA, NFS. d, 05385.

lagje dhe 23 fshatra krahinës së Gollobordës⁸; 3 çifligje, 2 lagje dhe 31 fshatra krahinës së Rekës së Madhe⁹; dhe 20 fshatra krahinës së Rekës së Vogël.¹⁰ Numri i popullsisë është llogaritur nga ana jonë, duke numëruar anëtarët e çdo familjeje të regjistruar nga punonjësit e gjendjes civile të kohës.

Në këtë vit, në Kazanë e Dibrenë së Epërme numri i shtëpive është 2.279 dhe numri i banorëve meshkuj jomyslimanë është 8.294.¹¹ Duke qenë se nuk janë të numëruara femrat, ashtu siç ndiqet dhe nga studiues të tjerë, edhe ne, për të nxjerrë një rezultat të përgjithshëm të popullsisë, do të shumëzojmë më dy numrin e popullsisë së meshkujve.¹² Kështu, duke përdorur këtë metodë, themi që numri i përgjithshëm i popullsisë jomyslimane është 16.558 banorë.

Në regjistrin e vitit 1845, popullsia jomyslimane dhe egjiptiane jomyslimane e myslimane është e pasqyruar sipas moshave dhe kategorive, sipas pasurisë së tyre.¹³ Këto informacione na ndihmojnë të formojmë një mendim për grupmoshat e popullsisë dhe nivelin ekonomik të saj.¹⁴ Grupimin sipas moshës dhe kategorisë së pasurisë, e kemi bërë sipas mënyrës së sugjeruar nga studiuesi Kemal Karpati.¹⁵ Sipas moshës: Meshkujt nën moshën 8-vjeçare klasifikoheshin si asgar (më të vegjlit), ata ndërmjet moshës 8 dhe 15 vjeç si sagir (të vegjlit), ata ndërmjet moshës 15 dhe 40 vjeç si şabi emred (pa mjekër), ata nga 40 deri në 60 vjeç si sinni-vusta (moshë e mesme) dhe ata mbi 60 vjeç si pir (pleq). Ndërsa taksapaguesit klasifikoheshin në tri kategori, sipas pasurisë së tyre: ala (mirë), evsat (mesatarë) dhe edna (e ulët). Përveç kësaj, ishte dhe një kategori e emërtuar amelmande, që përdorej për të grupuar personat jo të aftë për punë, të cilët ishin të përjashtuar nga dhënia e taksës së xhizjes. Sipas të

8 BOA, NFS. d, 05386.

9 BOA, NFS. d, 05387.

10 BOA, NFS. d, 05388.

11 Alketa Gjoni, *Debre Sancağı'nın İdari Ve Demografik Yapısı (1839-1913)*, Fatih Sultan Mehmet Vakıf Üniversitesi Lisansüstü Eğitim Enstitüsü Tarih Anabilim Dalı Tarih Programı, Yayınlanmamış Yüksek Lisans Tezi, İstanbul 2019, f. 36.

12 Daniel Panzac, *Osmanlı İmparatorluğu'nda Veba (1700-1850)*, Tarih Vakfı Yurt Yayınları, Çeviren Serap Yılmaz, İstanbul 1997, f. 134

13 BOA, NFS. d, 5391

14 Emine Tonta Ak, *19. Yüzyıl Edirne Nüfusu: Demografik ve Sosyal Bir Değerlendirme*, Edirne'nin Fethinin 650. Yılı Sempozyumu Bildirileri Kitabı, Edirne 2016, f. 237

15 Kemal H Karpat.: *Osmanlı Nüfusu (1830-1914) Demografik ve Sosyal Özellikleri*, Timaş Yayınları, İstanbul 2010, **po aty**, f. 50

dhënave për moshën në regjistër, kemi bërë klasifikimin e grupmoshave¹⁶ të popullsisë jomyslimane të qendrës së Kazasë së Dibrës së Epërme dhe krahinave në përbërje të saj, duke përllogaritur përqindjet që zë secila prej grupmoshave. Sipas këtij grupimi, nga 8294 banorë meshkuj, 25.5% i përkasin kategorisë asgar; 19.1% kategorisë sagir; 14.1% kategorisë şabi-emred; 11.3% kategorisë sinni vusta dhe 3% i përket kategorisë pir. Siç shihet, grumosha şabi-emred zë përqindjen më të madhe, duke pasur një rëndësi të veçantë ekonomike, pasi e gjithë popullsia jomyslimane e kësaj grupmoshe është e detyruar për dhënien e taksës së xhizjes.

Gjatë numërimit të popullsisë së qendrës së Dibrës së Epërme dhe krahinave përbërëse të saj, është bërë përllogaritja në përqindje që zë popullsia taksapaguese, sipas tri kategorive¹⁷ ala, evsat dhe edna. Kategoritë e taksapaguesve, sipas pasurive të tyre të shënuara në regjistra për një popullsi 8294 banorë meshkuj (me përjashtim të fëmijëve).¹⁸ Në vështrimin e përgjithshëm, në Kazanë e Dibrës së Epërme përqindjen më të madhe e zë kategoria evsat me 52.5%, që ndiqet nga kategoria edna me 10.3%, ndërsa kategoria ala zë 1.2% të popullsisë. Nga pjesa e popullsisë që nuk është e detyruar të japë taksa, zë 34.9% grupi i fëmijëve dhe 1.1% personat jo të aftë për punë.

Në kazanë e Dibrës së Epërme gjenden dy regjistra të vitit 1845, ku jepen të dhënat e 31 fshatrave për numrin e shtëpive, numrin e meshkujve të popullsisë egjiptiane myslimane¹⁹ dhe në regjistrin e dytë të dhënat e 3 lagjeve dhe 23 fshatrave për sasinë e taksave të përfutur nga kjo popullsi e kategorizuar sipas pasurisë së tyre ala, evsat, edna.²⁰ Numri i shtëpive është 91 me 91 banorë meshkuj egjiptianë, ku numri i përgjithshëm është 550 banorë. Nga këto, zonës më të banuar me 43 familje, 81 banorë meshkuj dhe numër të përgjithshëm 162 banorë në regjistër, nuk i është dhënë emërtimi, ndërsa numri i fshatrave me nga 1 banorë është 8. Siç vihet re, egjiptianët myslimanë i janë fshehur regjistrimeve të popullsisë.²¹

16 Gjoni, Debre Sancağı'nın idari ve Demografik... **po aty**, f. 40.

17 Gjoni, Debre Sancağı'nın idari ve Demografik... **po aty**, f. 45.

18 BOA, NFS.d, 05384, BOA, NFS.d, 05385, BOA, NFS.d, 05386, BOA, NFS.d, 05387, BOA, NFS.d, 05384

19 Gjoni, Debre Sancağı'nın idari ve Demografik... **po aty**, f.50-52; BOA, NFS. d, 15390.

20 BOA, ML.VRD.CMH. d, 00459.

21 BOA, NFS.d, 5391.

Popullsia e kazasë së Dibrës së Poshtme në regjistrin e vitit 1845

Në numërimin e popullsisë së kazasë së Dibrës së Poshtme, më 1845, gjenden 3 regjistra. Në defterin me numër BOA, NFS.d, 05389, nën etiketimin reaja (raja), është dhënë numri i shtëpive dhe i popullsisë jomyslimane të dy fshtarave të kazasë së Dibrës së Poshtme. Në regjistrin tjetër tregohet sasia e taksave të xhizjes së paguar nga popullsia egjiptiane jomyslimane në 1 lagje dhe 21 fshatra të kazasë, të dhëna që na ndihmojnë të nxjerrim përbërjen demografike të këtyre fshatrave.²² Ndërsa në regjistrin me numër BOA, NFS.d, 05390, tregohet numri i shtëpive, veçoritë fizike dhe mosha për popullsinë egjiptiane myslimane.²³

Sipas këtyre regjistrave, fshatrat e banuara nga popullsi jomyslimane në kazanë e Dibrës së Poshtme janë Dovolani dhe Herbeli. Fshati Dovolani ka 13 familje me 50 banorë meshkuj, me numër të përgjithshëm të popullsisë 100 banorë. Ndërsa në fshatin Herbel, në 37 familje jetojnë 113 banorë meshkuj, ku numri i përgjithshëm i popullsisë është 226 banorë. Pra, numri i përgjithshëm i familjeve jomyslimane në këto dy fshatra është 50 me 163 banorë meshkuj, me numër popullsie të përgjithshme 326 banorë. Sa i përket përllogaritjeve sipas grupmoshave, është vënë re një përqindje më e lartë e grupmoshës şab-ı emred, ndërsa në klasifikimin sipas pasurisë, mbizotëron kategoria evsat.²⁴

Në regjistrin tjetër janë nxjerrë të dhëna demografike nga klasifikimi i banorëve meshkuj egjiptianë myslimanë, sipas kategorive të pasurisë ala, evsat, edna. Në 26 vende banimi²⁵ jetojnë 63 banorë meshkuj, me popullsi të përgjithshme 126. Nga këta, janë të kategorizuar si evsat 39, si edna 24. Numri më i lartë i regjistruar është 8 banorë në fshatin Brexhdan, ndërsa në fshatrat e tjerë është regjistruar nga 4, 3, 2 ose 1 banorë për fshat. Një numër kaq i ulët vjen si shkak i fshehjes së kësaj popullsie nga punonjësit e zyrave të gjendjes civile, duke dashur t'i shpëtojnë dhënies së taksave. Sipas regjistrit të popullsisë, 16 fshatra të kazasë së Dibrës së Poshtme janë të banuar nga egjiptianë myslimanë. Në këto fshatra ka 30 shtëpi, ku numri i banorëve meshkuj është 48 dhe numri i përgjithshëm

22 BOA, ML.VRD.CMH.d.0459/16.

23 Në këtë regjister kuptohet që janë regjistruar popullsia egjiptiane myslimane, pasi emrat e personave janë Islam, Ahmed, Adem etj...

24 Gjoni, Debre Sancağı'nın idari ve Demografik... **po aty**, f. 54; BOA, ML.VRD.CHM.d, 0459/16.

25 Gjoni, Debre Sancağı'nın idari ve Demografik... **po aty**, f. 55-58.

i popullsisë është 96 banorë. Egjiptianët myslimanë të kazasë së Dibrës së Poshtme nga 48 banorë meshkuj 26.8%, i përkasin kategorisë asgar dhe sagir, 52.9% kategorisë şab-ı emdred, 16.2% dhe 4.1%, përkatësisht kategorive sinni–vusta dhe pir. Sipas kategorisë së pasurisë, nuk ka asnjë banor në kategorinë ala, 35 banorë janë të kategorisë evsat dhe 5 banorë të kategorisë edna.²⁶

Duke u bazuar në të dhënat e popullsisë të nxjerra nga ky regjistrim, mund të vlerësojmë madhësinë e familjes që llogaritet duke pjesëtuar numrin e përgjithshëm të popullsisë jomyslimane të kazave të Dibrës së Epërme dhe Dibrës së Poshtme, me numrin e përgjithshëm të shtëpive të këtyre kazave (17.686/2.450). Sipas këtyre përlllogaritjeve, madhësia e familjes është 7.22 persona. Kjo mesatare është më e lartë, duke e krahasuar me studimet e kryera për mesataren e përgjithshme të familjes osmane.²⁷ Kjo mund të lidhet me shpërndarjen e përbashkët të të ardhurave të siguruara nga toka e punuar²⁸, ose siç kemi konstatuar edhe nga regjistrat e popullsisë, në një shtëpi jetonin më shumë sesa një kurorë.

Popullsia e kazasë së Dibrës së Epërme dhe Dibrës së Poshtme në regjistrin e vitit 1848

Në regjistrimin e popullsisë së vitit 1848 gjenden dy regjistra që shpjegojnë strukturën e popullsisë për kazatë e Dibrës së Epërme dhe Dibrës së Poshtme. Në këto regjistra, në funksion të realizimit të reformave ushtarake dhe ekonomike, është bërë numërimi i popullsisë myslimane, egjiptiane myslimane dhe nën etiketimin reaja (raja) të popullsisë jomyslimane. Në regjistrin me numër BOA, NFS.d, 05425, është shënuar numri përgjithshëm i zonave të banuara, i familjeve dhe numri i përgjithshëm i popullsisë. Në regjistrin e dytë²⁹ fshatrat e kazave të sipër përmendura janë pasqyruar të ndara në dy grupime të mëdha. Në grupin e parë bëjnë pjesë vendbanimet jomyslimane, ndërsa në grupin e dytë vendbanimet myslimane të kazasë së Dibrës së Epërme dhe Dibrës

26 BOA, NFS.d, 05390.

27 Në shek. XIX mesatarja e madhësisë së familjes osmane ishte 4.10 persona. Tonta Ak, 19.Yüzyıl Edirne Nüfusu, **po aty**, f. 241.

28 Seyfullah Şahin, **Çatalca'nın Sosyo-Ekonomik Durumu: (XIX.Yüzyıl Ortaları)**, TC., İstanbul Üniversitesi, Sosyal Bilimler Enstitüsü, Tarih Anabilim Dalı, Yakınçağı Bilim Dalı, Yayınlanmamış Yüksek Lisans tezi, İstanbul 2015, f. 40.

29 BOA, ML.CRD.d, 00934.

së Poshtme, për të cilat është përcaktuar numri i meshkujve të popullsisë jomyslimane, myslimane dhe egjiptianëve myslimanë që jetonin në këto vendbanime. Gjatë regjistrimit është bërë dhe ndarja në popullsi vendase dhe popullsi e ardhur në këto vendbanime, pa përcaktuar zonën e ardhjes. Ky regjistrim është kryer nga drejtues ushtarakë dhe, pasi është vlerësuar nga zyrat përkatëse shtetërore, janë regjistruar në Zyrat e Gjendjes Civile.³⁰

Ashtu si në regjistrimin e vitit 1845, edhe në këtë regjistrim popullsia jomyslimane është përcaktuar duke bërë klasifikimin sipas kategorive ala, evsat dhe edna. Gjithashtu, në kategorinë amelmande, përveç personave jo të aftë për punë, fëmijët janë shënuar me emërtimin sagir dhe sibjan, që do të thotë të vegjlit. Ndërsa për ndryshim nga regjistri i vitit 1845, në vitin 1848 është bërë numërimi i popullsisë myslimane dhe është vlerësuar nga aspekti ushtarak. Personat që kanë arritur kushtet për të kryer ushtrinë, janë emërtuar si *tuvana*, ata që janë nën moshë për të kryer ushtrinë si *sibjan*, ata që e kanë kryer ushtrinë si *musin*.³¹ Gjatë numërimit, janë konstatuar edhe kategoria *nizamije* dhe *suvar*.³² Egjiptianët myslimanë janë kategorizuar vetëm në dy kategori: kebir (të rriturit) dhe sagir (të vegjlit).

Në vitin 1848 është bërë numërimi për 7 lagje të qendrës së kazasë së Dibrës së Epërme, për 190 fshatra dhe 70 lagje të kazave Dibra e Epërme dhe Dibra e Poshtme. Nga këto, më shumë zona të banuara me 85 fshatra, 44 lagje dhe 3 lagje të qendrave të banuara nga popullsia myslimane. Ndërsa numri i vendbanimeve ku jetonin së bashku jomyslimanët, myslimanët dhe egjiptianët myslimanë, ishte 13 fshatra. Numri i fshatrave ku jetonin jomyslimanë dhe myslimanë ishte 37 fshatra. Por në lagjet e kazasë Dibra e Epërme nuk vërehej të jetonin së bashku në asnjërën prej tyre popullsia myslimane dhe jomyslimane.³³

Në regjistrimin e vitit 1848 numri i popullsisë së përgjithshme për Kazanë e Dibrës së Epërme dhe Dibrës së Poshtme është 25.901 banorë meshkuj.³⁴ Popullsia myslimane përbën shumicën me 17.473 banorë meshkuj. Në regjistrimin e vitit 1845 kishte 63 egjiptianë myslimanë,

30 BOA, NFS.d, 5425

31 *Musin* është fjalë me origjinë arabe që ka kuptimin i moshuar. Për këtë arsye, është përdorur edhe si term në ushtri për personat “e moshuar në aspektin ushtarak”, pra që nuk mund të kryejnë funksione ushtarake. Mesut Birinci, Ali: Çakıcı, Mustafa; Topal, Zehra, **Akçabaabad Vakıfkebir Nüfus Kütüğü (1835-1845)**, Pelikan Basım Matbaa, İstanbul 2012, f. 97.

32 Në ushtri personat që kanë kryer katër vjet pozicionin e mbrojtësit dhe e kanë plotësuar me dy vjet shtesë shërbimin ushtarak, emërtohen nizmije, ndërsa kalorësit ushtarakë emërtohen suvar. Mehmet Kanar, **Osmanlı Türkçesi Sözlüğü**, Say Yayınları, İstanbul 2011, f. 931.

33 BOA, NFS.d, 05425.

34 Gjoni, Debre Sancağı'nın idari ve Demografik... **po aty**, f. 63.

por në këtë numërim nuk ka egjiptianë jomyslimanë, ndërsa numri i egjiptianëve myslimanë nga 323, ka zbritur në 146 banorë. Gjithashtu, edhe popullsia jomyslimane është zvogëluar me 177 persona më pak, pra nga 8.559 banorë në regjistrimin e tre viteve më parë, ka zbritur në 8.282 banorë. Nga 8.613 që është numri i shtëpive, 70% e zënë shtëpitë myslimane, 28% jomyslimanët dhe 1% ciganët myslimanë. Mesatarja e madhësisë së familjes përsëri është më e lartë se mesatarja e përgjithshme e familjes osmane, por vihet re që mesatarja e familjes myslimane me 5.78 persona është me diferencë 1.01 persona më pak, në krahasim me mesateren e familjes jomyslimane.³⁵

Në kazatë Dibra e Epërme dhe Dibra e Poshtme nga 17.473 banorë meshkuj myslimanë³⁶, 86.2% janë vendas dhe 13.8% janë të ardhur. Duke përlogaritur edhe popullsinë vendase, edhe atë të ardhur, 45.2% i përkasin kategorisë tuvana, 19.7% musin, 5.6% nizamije, 0.6% suvari, 0.6% janë zabtije dhe 28.3% janë të kategorisë sibjan. Egjiptianët myslimanë nuk janë ndarë sipas kategorive ushtarake, por sipas moshës, nga 146 banorë, 76 banorë i përkasin kategorisë kebir dhe 70 banorë kategorisë sagir. Ndërsa numri i jomyslimanëve³⁷ vendas dhe të ardhur ishte 8.282 banorë meshkuj, nga të cilët 1.7% i përkasin kategorisë ala; 54% kategorisë evsat dhe 11.3% kategorisë edna. Në grupin amelmande bënin pjesë 1%, ndërsa grupmosha e fëmijëve që në krahasim me përqindjen e grupmoshës së fëmijëve myslimanë ishte më e lartë, përbënte 32% të banorëve meshkuj. Gjithshashtu, në këtë regjistër tërheq vëmendjen edhe regjistrimi i 217 banorëve meshkuj latinë (katolikë) të kategorizuar sipas moshës: 158 si kebir dhe 59 si sagir.³⁸

Popullsia në vendbanimet joislame dhe islame në regjistrin e vitit 1848

Sipas regjistrin të dytë³⁹ të vitit 1848, në kazatë e Dibrës së Epërme dhe Dibrës së Poshtme grupimi i parë janë vendbanimet joislame me 3 çifligje, 30 lagje dhe 86 fshatra. Nga këto, numri i vendbanimeve ku bashkëjetonte popullsia myslimane, jomyslimane dhe egjiptianët myslimanë ishte 54. Në vendbanimet joislame, në 5082 shtëpi kishte 15.484 banorë meshkuj dhe një popullsi të përgjithshme prej 30.968 banorësh. Nga këto, në 2432

35 BOA, NFS.d, 05425.

36 Gjoni, Debre Sancaği'nın idari ve Demografik... **po aty**, f. 64.

37 Gjoni, Debre Sancaği'nın idari ve Demografik... **po aty**, f. 65.

38 BOA, NFS.d, 05425.

39 BOA, ML.CRD.d, 00934.

familje jomyslimane numërohen 8286 banorë meshkuj që sjell një numër të përgjithshëm të popullsisë 16.572 banorë. Popullsia myslimane në 2721 familje me 7022 banorë meshkuj, me numër të përgjithshëm popullsie 14.044 banorë. Ndërsa në 80 familje jetonin 176 banorë meshkuj, me numër të përgjithshëm popullsie 352 banorë egjiptianë myslimanë.

Në kazanë e Dibrës së Epërme numërohen 4104 shtëpi, nga të cilat 2386 shtëpi i përkasin popullsisë jomyslimane, 1651 shtëpi asaj myslimane dhe 67 familje të egjiptianëve myslimanë.⁴⁰ Në këtë kaza, nga popullsia prej 12.952 banorësh, 63% është jomyslimane, 36% popullsi myslimane dhe vetëm 1% popullsi egjiptiane myslimane.

Në këtë regjistër prej 1820 banorësh meshkuj të Kazasë së Dibrës së Epërme, përfshirë qendrën dhe krahinat përbërëse të saj, 7800 prej tyre iu është bërë klasifikimi sipas kategorive ala, esat, edna.⁴¹ Në vlerësim të përgjithshëm, përqindjen më të madhe e zë kategoria evsat me 54.9%, që ndiqet nga kategoria edna me 12.4%, ndërsa në kategorinë ala bëjnë pjesë 1.9%, pra është kategoria me përqindjen më të ulët. Nga banorët që nuk janë të detyruar të paguajnë taksa 30%, e përbëjnë fëmijët dhe 1.1% kategoria amelmande.

Numri i banorëve meshkuj myslimanë vendës dhe të ardhur të kazasë së Dibrës së Epërme që janë analizuar sipas klasifikimit me bazë ushtarake, është 4520 banorë.⁴² Nga këta, 17.5% janë të kategorisë musin, 44.6% tuvana, 5% nizamije. Ndërsa numri zabtijeve nuk jepet në këtë regjistër, numri i kategorisë suvar është 25. Egjiptianët myslimanë nuk janë vlerësuar sipas kategorive ushtarake, por sipas moshës, ku 98 janë të kategorisë kebir dhe 54 banorë të kategorisë sagir.

Në vendbanimet joislame të kazasë së Dibrës së Poshtme gjenden 1038 shtëpi me 2779 banorë meshkuj.⁴³ Edhe pse janë emërtuar si vendbanime joislame, përqindja më e madhe me 93% i përket popullsisë myslimane, ndërsa 6% janë jomyslimanë dhe 1% egjiptianë myslimanë.⁴⁴ Kjo dukuri mund të shpjegohet me konvertimin e popullsisë vendase në fenë islame.⁴⁵ Në këtë kaza numri i taksapaguesve është ⁴⁶ 164 banorë

40 Gjoni, Debre Sancaği'nin idari ve Demografik... **po aty**, f. 66-71

41 Gjoni, Debre Sancaği'nin idari ve Demografik... **po aty**, f. 76; 135; BOA, ML.CRD.d, 00934.

42 Gjoni, Debre Sancaği'nin idari ve Demografik... **po aty**, f. 78; 140; BOA, ML.CRD.d, 00934.

43 Gjoni, Debre Sancaği'nin idari ve Demografik... **po aty**, f. 75; 140.

44 BOA, ML.CRD.d, 00934

45 Në gjysmën e dytë të shek. XVIII konvertimi në fenë islame ishte i përhapur kudo në Dibër, përveç 10 fshatrave. Moisi Murra, **Dibra nga Antikiteti në Monarki**, Botimet M&B, Tiranë 2017, f. 125.

46 BOA, ML.CRD.d, 00934.

ku përqindjen më të madhe e zë kategoria evsat. Numri i kategorisë sagir është 62 dhe amelmande 5 banorë. Sa i përket kategorive në bazë ushtarake⁴⁷, është bërë klasifikimi i 2173 banorëve vendas dhe 405 banorëve të ardhur. Nga këto, kategorisë tuvana i përket 39.8%, ndërsa kategorisë musin 18.3%. Përqindja e kategorisë sibjan ishte 31.3%, nizamije 5.8% dhe suvari 4.8%.

Ndërsa në grupin e dytë të emërtuar si vendbanime islame numërohen 2 çifligje, 37 lagje dhe 60 fshatra, nga të cilat 2 çifligje, 8 lagje, 29 fshatra i përkasin kazasë së Dibrës së Epërme, ndërsa 26 lagje dhe 31 fshatra kazasë së Dibrës së Poshtme.⁴⁸ Në këto vendbanime gjithsej gjenden 4207 shtëpi me 10236 banorë meshkuj, ku numri i popullsisë së përgjithshme llogaritet të jetë 20 472. Nga këto, 94% e popullsisë është vendase. Ndërsa në vendbanimet joislame ishte 54 numri i vendeve ku bashkëjetonin jomyslimanët, myslimanët dhe egjiptianët myslimanë. Në këto vendbanime islame jetonin 99% myslimanë dhe 1% egjiptianë myslimanë, ndërsa nuk gjendej popullsi jomyslimane. Në këto vendbanime është numëruar dhe është bërë analiza sipas kategorive ushtarake e një popullsie prej 9400 banorë vendas dhe 601 banorë të ardhur. Në kategorinë tuvana bën pjesë 44.1% e popullsisë, musin 20.1%, sibjan 27.5%, nizamije 5.9% dhe në kategorinë suvari bën pjesë suvari 2.4% e popullsisë.⁴⁹

Popullsia e kazasë së Dibrës së Epërme në regjistrin e vitit 1853, 1858

Në regjistrimin e kryer në vitin 1853, gjenden dy regjistra. Në njërin regjister⁵⁰ është bërë numërimi i banorëve meshkuj, klasifikimi i tyre sipas kategorive të pasurisë, dhe në regjistrin tjetër jepen të dhëna për lindjet, vdekjet dhe lëvizjen migratore vetëm për popullsinë e kazasë së Dibrës së Epërme.⁵¹ Këto regjistrime janë kryer nga punonjësit vendas të gjendjes civile dhe më pas janë dërguar në qendrën civile qendrore.⁵² Regjistrimi i vitit 1853 është kryer për 2510 shtëpi, ku është regjistruar një popullsi prej 8407 banorë meshkuj. Nga kjo popullsi, kategoria ala zë 2.4%, evsat

47 BOA, ML.CRD.d, 00934.

48 BOA, ML.CRD.d, 00934.

49 Gjoni, Debre Sancağ'ının idari ve Demografik... **po aty**, f. 80-86; 148-150.

50 Gjoni, Debre Sancağ'ının idari ve Demografik... **po aty**, f. 153-156; BOA, NFS.d, 05427.

51 BOA, ML.CRD.d, 1629.

52 BOA, NFS.d, 05427.

56.5% dhe kategoria edna zë 9.7%. Në krahasim me regjistrimet e kryera pesë vite më parë, vihet re një rritje e numrit të familjeve me 68 familje, rritje e numrit të popullsisë me 113 banorë meshkuj më shumë dhe rritje me 1.2% rritje të kategorisë së banorëve me të ardhura të larta. Popullsia që nuk është e detyruar në dhënien e taksave, zë 30% grupmosha e fëmijëve dhe 1.5% janë banorë jo të aftë për punë.

Përgjatë shekullit XIX, shoqëria dibrane ka qenë në lidhje të vazhdueshme me kryeqytetin osman. Anëtarë të familjeve të rëndësishme të zonës së marrë në studim, kryenin studimet në Stamboll. Gjithashtu, shoqëria dibrane e cila e kishte të vështirë të siguronte të ardhura në vend, ishte e detyruar të migronte për arsye pune në qytete të ndryshme osmane, veçanërisht në Stamboll.⁵³

Sipas regjistrimeve të vitit 1853⁵⁴, numri i banorëve që kanë lëvizur për qëllim punësimi në kazanë e Dibrës së Epërme, është 98 banorë.⁵⁵ Prej tyre, 50% kanë preferuar të lëvizin drejt kryeqytetit osman. Në kryeqytet me 55.1%, më së shumti kanë lëvizur banorët e krahinës Reka e Madhe. Vende të tjera në të cilat kjo shoqëri ka lëvizur për arsye punësimi, janë Plavna, Saraferja, Varna, Beogradi, Shkupi, Kumanova dhe qyteti i Shkodrës. Ndërsa, sa i përket zanatit që kanë ushtruar më shumë në vendet ku kanë lëvizur, ishte zdrukhtaria me 58.2%. Për të ushtruar këtë zanat, më së shumti lëviznin banorët e krahinës së Rekës së Vogël. Vendin e dytë e zinte tregtimi i simiteve që kryhej më së shumti nga banorët migruer të krahinës së Rekës së Madhe. Arsye tjetër e migracionit ishte edhe tregtia, ku konstatohet largimi të paktën i një banori nga çdo krahinë e kazasë. Gjithashtu, në këtë regjistër shënohet edhe periudha e qëndrimit të banorëve migruer. Përgjithësisht, në 79.5% të rasteve qëndronin gjashtë muaj. Numri i banorëve që kanë qëndruar në migracion një vit, është 13 banorë.

53 Në Stamboll shumë anëtarë të familjes Zogolli, ashtu si Xhemal Pasha, kishin kryer studimet në Stamboll. Në vitin 1909-1910, në kryeqytetin osman ndiqnin studimet jashtë fushës fetare dhe ushtarake 121 studentë shqiptarë, nga të cilët 5 ishin dibranë, dy nga Reka kishin studiuar drejtësi, një student mjekësi dhe dy të tjerë ekonomi bujqësore. Dibranët studionin edhe teologji. Kështu, nga 33 nxënës të medreseve, 3 ishin nga Dibra ose nga Reka. Krerët fetarë si Said Najdeni, Haxhi Vildan Efendi, Vehbi Agolli, janë shembull për këtë. Ata dhanë kontribut të rëndësishëm fetar dhe atdhetar në fundin e shek. XIX. Nathalie Clayer, **Arnavut Milliyetçiliğinin Kökenleri Avrupa'da Çoğunluğu Müslüman Bir Ulusun Doğuşu**, İstanbul Bilgi Üniversitesi yayınları, Çeviren Ali Berktaş, İstanbul, 2013, f. 69; Mahmud Hysa, **Said Najdeni – Hoxhe Voka, Hafiz Sherif Langu**, İnstituti Per Trashegimi Kulturore dhe Shpirtërore te Shqipëtareve Shkup, İTKSHSH Studime 6, Shkup, 2013, f. 43

54 BOA, ML.CRD.d, 1629.

55 Në këtë regjistër janë regjistruar 5 persona të lindur dhe 11 të vdekur. BOA, ML.CRD.d, 1629.

Bibliografia

1. **Arkivi Osman:** BOA, NFS, 05384; BOA, NFS, 05389; BOA, ML.CRD.d, 00934; BOA, NFS.d, 05384; BOA, NFS.d, 05385; BOA, NFS.d, 05386; BOA, NFS.d, 05387; BOA, NFS.d, 05388.
2. Ak, Emine Tonta: “19. Yüzyıl Edirne Nüfusu: Demografik ve Sosyal Bir Değerlendirme”, **Edirne’nin Fethinin 650. Yılı Sempozyumu Bildirileri Kitabı**, Edirne 2016, f. 231-263.
3. Clayer, Nathalie: **Arnavut Milliyetçiliğinin Kökenleri Avrupa’da Çoğunluğu Müslüman Bir Ulusun Doğuşu**, İstanbul Bilgi Üniversitesi yayınları, Çeviren Ali Berktaş, İstanbul, 2013.
4. Gjoni, Alketa: **Debre Sancağı’nın İdari Ve Demografik Yapısı (1839-1913)**, Fatih Sultan Mehmet Vakıf Üniversitesi Lisansüstü Eğitim Enstitüsü Tarih Anabilim Dalı Tarih Programı, Yayınlanmamış Yüksek Lisans Tezi, İstanbul, 2019.
5. Gjoni, Alketa: *Ndarja dhe Organizimi Administrativ i Sanxhakut të Dibrës gjatë viteve (1839-1912)*, **Revista Shenja**, Shkurt 2020, f. 84-88.
6. Hysa, Mahmud: **Said Najdeni – Hoxhe Voka, Hafiz Sherif Langu**, İnstituti Per Trashegimi Kulturore dhe Shpirtore te Shqipetareve Shkup, İTKSHSH Studime 6, Shkup 2013.
7. Jelavich, Barbara: **Balkan Tarihi 18. Ve 19. Yüzyıllar**, Küre Yayınları, Cilt 1, İstanbul, 2009.
8. Karpat, Kemal H.: **Osmanlı Nüfusu (1830-1914) Demografik ve Sosyal Özellikleri**, Timaş Yayınları, İstanbul, 2010.
9. Kanar, Mehmet: **Osmanlı Türkçesi Sözlüğü**, Say Yayınları, İstanbul, 2011.
10. Mesut Birinci, Ali: Çakıcı, Mustafa; Topal, Zehra, **Akçabaabad Vakıfkebir Nüfus Kütüğü (1835-1845)**, Pelikan Basım Matbaa, İstanbul, 2012.
11. Murra, Moisi: **Dibra nga Antikiteti ne Monarki**, Botimet M&B, Tiranë, 2017.
12. Panzac, Daniel: **Osmanlı İmparatorluğu’nda Veba (1700-1850)**, Tarih Vakfı Yurt Yayınları, Çeviren Serap Yıkılmaz, İstanbul, 1997.
13. Şahin, Seyfullah: **Çatalca’nın Sosyo-Ekonomik Durumu: (XIX.Yüzyıl Ortaları)**, TC., İstanbul Üniversitesi, Sosyal Bilimler Enstitüsü, Tarih Anabilim Dalı, Yakınçağı Bilim Dalı, Yayınlanmamış Yüksek Lisans tezi, İstanbul, 2015, f. 40.